



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I MBROJTJES SË KONSUMATORËVE

---

VENDIM

Nr. 24, Datë 03.05.2012

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve me pjesëmarrjen e:

- Znj. Anila jani Kryetarë
- Znj. Marsida Xhaferllari Anëtare
- Z. Zamir Mocka (Stefani) Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 03.05.2012, ka vazhduar shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve ndaj operatorit CEZ Shpërndarje, duke shqyrtuar shkresën e Entit Rregullator të Energjisë, me shkresën nr. Prot (ERE). 361/1, datë 12.03.2012, drejtuar operatorit CEZ Shpërndarje, dhe Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve për dijeni, ndaj kërkesës për informacion të Komisionit, drejtuar operatorit CEZ Shpërndarje dhe ERE-s për dijeni, me shkresën nr. prot 46/2, datë 28.02.2012, në lidhje me kërkesën për informacion për ankesat e konsumatorëve ndaj operatorit CEZ Shpërndarje.

Komisioni pas shqyrtimit të shkresës së sipërpërmendur,

VËREN SE:

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve ka filluar në mbledhjen e datës 14 gusht 2011, shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve ndaj operatorit CEZ Shpërndarje, në lidhje me: mungesën e furnizimit me energji elektrike për një periudhë të gjatë; mosdorëzimin e faturave të energjisë në vendbanimet e konsumatorëve; mosinformimin në kohë të konsumatorëve në lidhje me ndryshimin e vendndodhjes së sporteve, ku behet pagesa e faturave të energjisë elektrike, duke shkaktuar detyrimin e konsumatorëve për pagesë të kamatëvonesave; vendosjen aforfe të shumave të konsiderueshme (rreth 1000 kë/ore në muaj) në faturat e energjisë; vendosjen e zërit “vlere e debisë” në shuma të konsiderueshme.

Komisioni për një procedim të mëtejshëm të çështjes, me shkresë nr. prot 25/1, datë 10.08.2011, i ka kërkuar operatorit CEZ Shpërndarje informacion të detajuar, të argumentuar dhe të verifikueshëm, me evidencat përkatëse, sipas problematikave të sipërpërmendura, për një periudhë 1 vjeçare si dhe vënien në dispozicion të listave të plota, të të gjithë abonentëve, që kanë pasur ndërprerje të furnizimit me energji elektrike, të konsumatorëve të gjobitur, të konsumatorëve që janë faturuar aforfe (1000 kwore/muaj), të konsumatorëve, të cilët janë faturuar me zërin “vlere e debisë”, si dhe të gjitha evidencat përkatëse në lidhje me ndryshimin e vendndodhjes së sporteve dhe informimin e konsumatorëve, për një periudhë 1 vjeçare (korrik 2010-korrik 2011).

Ne mbledhjen e datës 7.11.2011, Komisioni konstatoi se CEZ Shpërndarje nuk ka dhënë informacionin e kërkuar nga Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve, duke shkelur nenin 52/1 të Ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar dhe me Vendim nr.17, date 07.11.2011, vendosi gjobitjen e CEZ Shpërndarje me shumën prej 300,000 leke. Ky Vendim i përcillet CEZ Shpërndarje me shkresën nr. prot. 25/3, date 14.11.2011.

Ne mbledhjen e datës 27.01.2012, Komisioni konstatoi se amendimet e Ligjit Nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, nga Ligji nr. 10485, date 26.11.2011, ngarkojnë ERE për vendosjen e gjobave në rast të shkeljes së “moszbatimit nga i licensuari i detyrimeve të përcaktuara në kontratat e rregulluara”, si dhe për “shkeljen e një prej kushteve të standardeve të cilësisë së furnizimit të miratuara nga ERE”.

Komisioni konstatoi se në Kushtet e përgjithshme të kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientët familjare, që ka hyre në fuqi në 1 janar 2012, përcaktohen ndërmjet të tjerave detyrimet e furnizuesit të energjisë për leximin e matësit dhe faturimin e energjisë elektrike.

Komisioni vendosi të vijojë shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve, në baze të nenit 22/2 të Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, me cilësinë e organit administrativ që ishte kompetent në fillim të procedimit e do të vazhdojë të jetë i tillë deri në përfundimin e tij, pavarësisht transferimit ligjor të kompetencave një organi tjetër.

Komisioni me shkresën nr. Prot 46 (KMK), date 31.01.2012, i rikërkoj operatorit CEZ Shpërndarje informacionin e munguar, duke i bërë me dije se, mosdhënia e informacionit sipas kërkesës së Komisionit përbën shkelje të përsëritur administrative sipas pikës 4 të nenit 57 të ligjit 9902, i ndryshuar.

Në mbledhjen e datës 22.02.2012, Komisioni konstatoi se CEZ Shpërndarje me shkresë nr. prot. date 602/1, datë 10.02.2012, operatori ka adresuar vetëm disa nga ankesat e dërguara në vijim pranë Komisionit, pas date 14 gusht 2011, dhe përsëri mungon informacioni i detajuar i kërkuar me shkresë nr. prot. 25/1, date 10.08.2011. Komisioni konstatoi se kjo është shkelje e përsëritur e nenit 52/1 nga ana e operatorit CEZ Shpërndarje dhe me Vendim nr.21, date 22.02.2012 vendosi gjobitjen e CEZ Shpërndarje me shumën prej 600,000 leke.

Komisioni, në mbledhjen e datës 03.05.2012, administroi shkresën e ERE, drejtuar për dijeni Komisionit, me shkresë nr. prot. (ERE) 361/1, date 12.03.2012, sipas të cilës ERE i kërkonte operatorit CEZ Shpërndarje, “informimin e Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Entit Rregullator të Energjisë, sipas kërkesave të shkresës nr. prot. (KMK) 46/2, date 29.02.2012, brenda datës 26.03.2012”.

Për sa me lart, Komisioni gjykon se, problematika e ankesave të një numri konsumatorësh ndaj operatorit CEZ Shpërndarje, është praktike që bie në kundërshtim me pikat 1, 2 dhe 5 të nenit 40 si dhe pikës 1 të nenit 41 dhe dëmton interesat kolektive të konsumatorëve.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve mbështetur në pikat 1, 2, 4 dhe 5 të nenit 40; pikës 1 të nenit 41; nenit 52; nenit 52/1; nenit 55 të Ligjit nr. 9902, date 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, si dhe në shkronjat “a” dhe “c”, të pikës 6 të VKM nr. 1444,

datë 22.10.2008 "Për mënyrën e funksionimit e te pagesës se anëtareve te Komisionit te Mbrojtjes se Konsumatorëve, si dhe përcaktimin e procedurave te vlerësimit te shkeljeve" .

**VENDOSI:**

1. Operatori CEZ Shpërndarje, te ndalojë shkeljet për:
  - a) Mungesën e vazhdueshmërisë se furnizimit me energji elektrike te konsumatorëve;
  - b) Mosdorëzimin e faturave te energjisë ne vendbanimet e konsumatorëve;
  - c) Mos informimin ne kohë te konsumatorëve ne lidhje me ndryshimin e vendndodhjes se sporteleve, ku behet pagesa e faturave te energjisë elektrike;
  - d) Mungesën e faturimit te energjisë elektrike ne baze te konsumit real te vlerësuar në aparatet matës (faturimi aforfe dhe vendosja ne fature e zërit "vlere e debisë");
2. Operatori CEZ Shpërndarje, te marre masat për mos përsëritjen e shkeljeve;
3. Te njoftohet Enti Rregullator i Energjisë për marrjen e këtij vendimi.

**KRYETAR I KOMISIONIT**



**ANILA JANI**